



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić – Municipality Assembly Obiliq

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt.31.03.2026, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Albanë Shillova Shalaku (LVV), Arbenita Pllana (LVV), Bardhyl Mjekiqi (LVV), Burim Ismaili (LVV), Fitim Grajçevci (LVV), Fjolla Nasufi (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Mervete Shala (LVV), Sami Ahmeti (LVV), Abdyrrahman Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Enver Gashi (LDK), Fidan Ahmeti (LDK), Fitore Hashani (LDK), Labinot Mirena (LDK), Linda Bekteshi, (LDK), Muhamet Preniqi (LDK), Vlora Mjekiqi Kabashi (LDK), Goran Dancetovic (SL), Biljana Spasic (SL) dhe Dorentina Mustafa (AAK).

**Të pranishmit tjerë:** Kryetari i Komunës, HalilThaqi, Berat Gashi, Nënkryetar i Komunës, drejtorët komunal, Arta Mjekiqi, zyrtare ligjore përf. e FSK-së dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesuesi cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkeses së Kryetarit të Komunës me nr. 02-020-01-7220-26 për Formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkeses së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për emërimin e Komisionit Për përzgjedhjen e Këshillave lokale në Komunën e Obiliqit
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkeses së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për themelimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së Këshillave të fshatrave
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkeses së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për miratimin e Draft-Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës për zgjedhjen e delegatëve që do të përfaqësojnë Komunën e Obiliqit
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së anëtarit të Kuvendit z.Mirena për orarin e kujdestarisë së barnatoreve në Obiliq
9. Të ndryshme

**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, dhe propozoi që si pikë e 9 e rendit të ditës të jetë shqyrtimi dhe aprovimi i rekomandimit të KPF-së për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Miratohet rendi i ditës me 21 vota për me propozimin e cekur më lartë.

#### **Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal ishin të pranishëm.

#### **Pika 2 e rendit të ditës**

**Goran Dancetovic** – Pasi kam verifikuar procesverbalin në shqip dhe serbisht, procesverbali gabimisht paraqet votën për zgjedhjen e nënkryetarit të Komunës së Obiliqit para komuniteteve, ku deklaruar se 13 këshilltarë e kanë përkrahur propozimin e kryetarit për zgjedhjen e Stevan Radosavljevic për nënkryetar për komunitete dhe 7 kanë abstenuar. Ky nuk është rezultati i duhur sepse unë dhe kolegu im ishim kundër atij propozimi, pra është e saktë që është 2 kundër. Këshilltarët që përfaqësojnë komunitetet pakicë votuan kundër propozimit. Ju lutemi korrigjoni atë dhe mund të kontrolloni edhe me video procesverbal se si kemi votuar ( mendon në video inqizim).

**Kryesuesi** – Ndodhë që të jetë bërë gabim, por sido që të jetë ne do të shohim dhe do ta bëjmë përmirësimin.

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 21 vota për me vërejtjen e cekur më lartë.

#### **Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për Formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB). Bazuar në Udhëzimet Administrative ky Këshill në Komunën tonë do të jetë i përbërë nga 21 anëtarë dhe do të udhëheqet nga Kryetari i Komunës, z.Halil Thaqi.

Kryesuesi, pastaj i njoftoi të pranishmit me propozimet e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për morën Vendim për Formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) me këtë përbërje:

1. Halil Thaqi, Kryetar i Komunës
2. Baron Murati, Komandant i Stacionit Policor në Obiliq
3. Ymërdin Hasani, Përfaqësues nga Forca e Sigursisë së Kosovës
4. Rexhep Qerkezi, Përfaqësues i Bashkësisë Islame
5. Zelushe Kelmendi, Kryesuese e Komitetit Lokal për Siguri Publike (KLSP)
6. Sevdije Berisha Krasniqi, Drejtore e Drejtorisë së Arsimit
7. Naim Shabani, Përfaqësues i Këshillit të prindërve
8. Fatime Halimi, Përfaqësuese e Qendrës për Punë Sociale
9. Ganimete Aliu, Zyrtare për Barazi Gjinore
10. Eljesa Tërbunja, Përfaqësues nga OJQ “Handikos”
11. Albanota Hyseni, Përfaqësuese nga Qendra Rinore
12. Valon Berisha, Përfaqësues nga Sektori i Emergjencës
13. Fanol Shala, Përfaqësues i ekipit të Kërkim-shpëtimit
14. Fitim Sadiku, Përfaqësues i Kryqit të Kuq
15. Bahri Gashi, Koordinator i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSB)
16. Faton Beka, Kryesues i Komitetit për Komunitete
17. Ivana Spasic, Përfaqësuese e Zyrës për Komunitete dhe Kthim
18. Aleksandar Napalic, Përfaqësues nga komuniteti ortodoks
19. Stevan Radosavljevic, Përfaqësues nga komuniteti serb
20. Lejla Boshnjak, Përfaqësues nga komuniteti boshnjak
21. Shaban Berisha, Përfaqësues nga komuniteti rom

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DAP-së për emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e Këshillave lokale në Komunën e Obiliqit dhe fjalën ia dha drejtoreshës së administratës së përgjithshme.

**Ariana Grajqevci** - Në bazë të Rregullores nr.03/2022 për organizimin funksionalizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, mandati i Këshillave lokal veç se ka përfunduar. Me fillimin e mandatit të ri është e nevojshme të ndërmerren procedura për përzgjedhjen e Këshillave lokal. Sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje Kuvendi i Komunës emëron Komisionin për përzgjedhjen e Këshillave lokal i cili udhëheqë dhe koordinon procesin e zgjedhjes. Ky Komision përbëhet prej 7 anëtarëve, ku prej tyre 4 anëtarë janë nga Kuvendi i Komunës, 1 nga Ekzekutivi, 1 nga shoqëria civile dhe 1 nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e Këshillit lokal i cili zgjedhet në mënyrë ad hoc. Prandaj, kërkoj nga Kuvendi i Komunës të bëhet përzgjedhja e Këshillave lokal në përputhje me dispozitat e Rregullores në fuqi.

**Kryesuesi** – Ajo që është e rëndësishme në këtë Komision është se Komisioni duhet të reflektoj edhe barazinë gjinore. Në Komision konsiderojmë se 2 anëtarë do të jenë nga LVV-ja dhe 2 nga LDK-ja.

**Fjolla Nasufi** – Nga LVV-ja, propozojmë z.Burim Ismaili dhe znj.Mervete Shala, për anëtarë të Komisionit.

**Fitore Hashani** – Nga LDK-ja, propozojmë z.Fidan Ahmeti dhe znj.Linda Bekteshi.

**Kryesuesi** – Sa i përket Ekzekutivit drejtoresha e administratës znj.Ariana Grajqevci dhe nga shoqëria civile znj.Zelushe Kelmendi janë propozimet për anëtare të Komisionit ndërsa anëtari i 7 vjen nga lokaliteti ku mbahet mbledhja e Këshillit lokal.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota për dhe 2 vota abstenim morën Vendim për Emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e Këshillave Lokale në Komunën e Obiliqit, me këtë përbërje:

1. Burim Ismaili – anëtar i Kuvendit nga LVV
2. Mervete Shala – anëtare e Kuvendit nga LVV
3. Linda Bekteshi – anëtare e Kuvendit nga LDK
4. Fidan Ahmeti – anëtari Kuvendit nga LDK
5. Ariana Grajqevci – drejtore e Administratës (përfaqësuese nga Ekzekutivi)
6. Zelushe Kelmendi, përfaqësuese nga shoqëria civile
7. Përfaqësuesi nga Lokaliteti ku bëhet zgjedhja e Këshillit Lokal

#### **Pika e 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DAP-së, për themelimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së Këshillave të fshatrave dhe fjalën ia dha drejtoreshës së administratës së përgjithshme.

**Ariana Grajqevci** – Sipas nenit 9 të së njëjtës Rregullore, Kuvendi i Komunës themelon edhe Komisionin për ankesa, i cili shqyrton ankesat lidhur me procesin e zgjedhjes së Këshillave lokale. Ky Komision përbëhet prej 3 anëtarëve nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, por anëtarët nuk duhet të jenë të njëjtë nga Komisioni paraprak.

**Kryesuesi** – Edhe në këtë Komisioni duhet të jetë barazia gjinore dhe 1 anëtarë propozohet nga LVV-ja, 1 nga LDK-ja dhe e pyes znj.Doruntina nëse pranon të jetë anëtare e Komisionit në fjalë.

**Fjolla Nasufi** – Nga LVV-ja, propozojmë znj.Arbenita Pllana, anëtare të Komisionit.

**Fitore Hashani** – Nga LDK-ja, propozojmë z.Bajram Hashani.

**Abdyrrahman Krasniqi** – Propozon znj.Dorentina Mustafa, nga AAK-ja.

Pas propozimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota për dhe 2 abstenime morën Vendim për Themelimin e Komisionit të Ankesave për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e përzgjedhjes së Këshillave Lokale në Komunën e Obiliqit, me këtë përbërje:

- 1.Arbenita Pllana – anëtare e Kuvendit nga LVV
- 2.Bajram Hashani – anëtar i Kuvendit nga LDK

**Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DAP-së, për miratimin e Draft-Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit dhe fjalën ia dha drejtoreshës së administratës.

**Ariana Grajqevci** – Draft Kodi i Etikës është hartuar dhe me dt.16 shkurt 2026 është vendos në debat publik. Gjatë afatit të paraparë për konsultim publik nuk është pranuar asnjë koment apo sugjerim lidhur me përmbajtjen e këtij Drafti. Duke qenë se nuk ka pasur propozime për ndryshim apo plotësim Komisioni përkatës ka vlerësuar se Draft Kodi i Etikës është i gatshëm për procedim të mëtejshëm për miratim në Kuvend.

**Fjolla Nasufi** – Jemi në rregullë me këtë pikë të rendit të ditës.

**Fitore Hashani** – E falenderojmë Komisionin që ka punue në këtë Draft Rregullore dhe sa i përket LDK-së, gjithçka është në rregullë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për morën Vendim për Miratimin e Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

**Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës për zgjedhjen e delegatëve që do të përfaqësojnë Komunën e Obiliqit. Me dt.16 mars 2026 kemi pranuar ftesën dhe agjendën për Kuvendin zgjedhor për Asociacionin e Komunave të Kosovës i cili do të mbahet me dt.16 prill 2026. Me këtë ftesë kërkohet që sipas Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kuvendi i Komunës të zgjedhë delegatët që do të përfaqësojnë Komunën e Obiliqit. Sipas nenit 4 pika 4.3 e Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kuvendet Komunale e delegojnë për çdo 10 anëtarë një përfaqësues në Kuvendin e Asociacionit. Pra, Komuna e Obiliqit duhet të përfaqësohet me 2 anëtarë ndërsa, Kryetari i Komunës shkon me automatizëm.

**Fjolla Nasufi** – Nga LVV-ja, propozojmë znj.Lendita Krasniqi.

**Linda Bektashi** – Nga LDK-ja, propozojmë znj.Fitore Hashani.

**Abdyrrahman Krasniqi** – Propozon z.Labinot Mirena.

**Kryesuesi** – E kemi një propozim më tepër se që e kemi mundësinë me zgjedhë.

Anëtarët e Kuvendit Komunal për propozimin e parë për znj.Lendita Krasniqi dhe znj.Fitore Hashani votuan me 7 vota për 12 vota kundër dhe 2 vota abstenim ndërsa për propozimin e dytë për znj.Lendita Krasniqi dhe z.Labinot Mirena votuan me 12 vota për dhe 7 vota kundër dhe 2 vota abstenim morën Vendim për Emërimin e delegatëve që do ta përfaqësojnë Komunën e Obiliqit në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, me këtë përbërje: 1.Halil Thaçi, Kryetar i Komunës së Obiliqit, 2.Lendita Krasniqi, anëtare e Kuvendit nga LVV, 3.Labinot Mirena, anëtar i Kuvendit nga LDK.

**Bajram Hashani** – Sa ke qenë në opozitë me të vërtetë ke qenë shumë parimor, shumë i kujdesshëm dhe shumë i sjellshëm, por tash në pushtet ke ndryshue z.Sami je pak më ndryshe.

**Kryesuesi** – Unë për ty nuk mund të them të njejtën se nuk kam ditë qysh ke qenë sepse nuk ke folë kurrë.

**Bajram Hashani** - Të kam tregue pse nuk kam folë.

**Fitore Hashani** - Vetëm nuk e dëgjuam kush e propozoi z.Labinot Mirena në emër të kujt shkon ose cilin subjekt do ta përfaqësoj. Me siguri i ka ikë z.Abdyrrahman Krasniqi meqenëse, e the qysh në fillim nga 2 subjektet më të mëdha kërkohen përfaqësuesit vetëm të kemi të qartë për opinion dhe për Ministriyë përgjegjëse se kush dhe kend e përfaqëson z.Labinot Mirena përveç si asambleistë që është në Kuvendin e Obiliqit.

**Kryesuesi** - Përfaqësimin e këtij Kuvendi e përfaqësojnë të gjithë anëtarët që kanë dalë nga zgjedhjet, aq më tepër ne kemi vendimin e fundit të Komisionit zgjedhor të Kosovës, që i nxjerrë anëtarët fitues prej secilit subjekt. Deri më tani unë konsideroj se askush nuk mundet me ia cënue të drejtën një anëtarit me qenë në një subjekt politik apo me vendos për tjetrin se ku duhet të jetë. Deri në këtë moment përveç një shkresë që ju thoni se këta nuk përfaqësojnë politikën e LDK-së, ne nuk kemi ndonjë shkresë nga

Komisioni zgjedhor i Kosovës, që është organi i vetëm që konstaton se kush cilit subjekt i takon. Ne nuk kemi dorëheqje nga personat në fjalë dhe unë konsideroj se personat në fjalë janë përfaqësues të LDK-së.

**Fitore Hashani** – Faleminderit për sqarime kryesues. Të gjitha këto sqarime edhe ne i kemi të qarta kështu që do të donim të vendosim prapë Ministria dhe vendimet gjegjëse. Derisa nuk e propozon askush se kush është dhe kend e përfaqëson z.Labinot Mirena duhet të presim përgjegje të drejtë.

**Enver Gashi** – Kryesues ju fillimisht kur e hapët këtë temë thatë që duhet një përfaqësues nga LDK-ja dhe një nga LVV-ja. Në LDK dihet shumë mirë se kemi shef grupi dhe shefi i grupit propozoi tash nuk e di nga po rrjedhë kjo tjetra. Tash me iu tek edhe 7 tjerëve, edhe 20 tjerëve nga një ku shkojmë ne.

**Abdyrrahman Krasniqi** – Kryesues faleminderit shumë që po na mbron edhe ti LDK-në, por unë veç e përgëzoj znj.Fitore për pozitën e shefes edhe do e shohim se a do të qëndroj afatgjatë apo afatshkurtë, a mundet me i interpretue mesazhet e shefave. Ne këtu, e përfaqësojmë Kuvendin dhe i përfaqësojmë qytetarët e Komunës së Obiliqit. Nëse, këta folin me emra të shefave atëherë le të japin dorëheqje dhe le të dalin ti përfaqësojnë shefat. Unë jam asambleistë i Lidhjes Demokratike në Obiliq, dhe foli në emër të qytetarëve dhe votuesve të mi, njëkohësisht njëjtë është edhe z.Labinot Mirena të cilin e propozova. Nëse, këta mendojnë se në demokraci ka shefa e ata vendosin se kend ne e propozojmë atëherë, unë iu them këtu se e kanë shumë gabim.

**Labinot Mirena** - Është interesantë znj.Fitore pse ma bëri këtë pyetje do të thotë të pyeti ty kryesues për mua se vërtetë i kemi ndërrue partitë shumë dhe ndoshta tash znj.Fitore nuk e din se në cilën parti jemi se unë qe 3 mandate që jam asambleistë jam me 3 parti të ndryshme. Bashkë me znj.Fitore jemi dhe kemi rrugëtue bashkë. Në vitin 2030 mund të jemi në një parti tjetër unë dhe znj.Fitore bashkë prapë, kështu që ne jemi në LDK znj.Fitore dhe besoj se do të jemi në LDK bashkë. Unë jam asambleistë i LDK-së dhe do të qëndroj besnik ndaj elektoratit tim.

**Bajram Hashani** - Krejtë kjo është në rregullë çka po thotë z.Labinot dhe z.Abdyrrahman dhe këta veç në LDK nuk munden me qenë e gjithkund tjetër po.

**Abdyrrahman Krasniqi** - E z.Xhafer a është në LDK.

**Bajram Hashani** – Po z.Xhafer është në LDK dhe më i fortë në LDK se krejtë ne këtu që jemi. Edhe në LPK e në të gjitha është por për momentin është në LDK, është Kryetar shumë i merituar, shumë i respektuar, njeri që ka dhënë shumë për Obiliqin bashkë me ekipin e gjithë bashkëpunëtorët e vetë.

**Abdyrrahman Krasniqi** – Profesor shumë gjëra na ke mësue, veç këtë herë po të mësojmë ne ty se shumë gabim e ke me përcaktu ti se kush është në LDK e kush nuk është në LDK. Ne kemi marrë besim me përfaqësue qytetarin në mënyrë demokratike. Nëse, qytetarët kanë ankesa te na atëherë, ne mund të bisedojmë dhe me i trajtu ato kërkesa ndoshta, edhe me rishikue mandatin tonë ndërsa shefat nuk munden. Nëse, ti je i dëgjueshëm dhe znj.Fitore u bë e dëgjueshme unë nuk e kam në plan me u bë i dëgjueshëm.

**Bajram Hashani** - Njerëzit duhet me dëgjue, por duhet me ditë kend me dëgjue. Z.Labinot dhe z.Abdyrrahman kanë marrë vota në emër të LDK-së, por e kanë tjetërsue vullnetin e LDK-së. Këta po punojnë për tjetërkend dhe nuk janë duke punue për LDK-në.

**Kryesuesi** – Z.Hashani, nuk kemi të drejtë asnjëri me komentue tjetrin çka bën dhe si bën.

**Bajram Hashani** – Kjo po duket.

**Kryesuesi** - Është dukë edhe më heret me ty tjetërkund ke marrë dhe tjetërkund ke bartë.

**Abdyrrahman Krasniqi** – LDK ke qenë dhe ke punue për tjetër parti, e ke marrë mandatin. Ti duhet me qenë falenderues edhe ndaj neve, që të kemi bë deputet sepse nuk ke hy me u matë te qytetarët e me dalë me kërkuë vota.

**Kryesuesi** - Është mirë që kemi institucione, i kemi Ministrinë që merren me shqyrtimin e ligjshmërisë së secilit akt dhe nëse konsiderohet që është bërë gabim nuk është fundi i botës, kthehemi përsëri dhe bisedojmë.

**Bajram Hashani** - Një sqarim për qytetarët, është e vërtetë se unë i kam ndihmue iniciativës për balotazh që nuk e mohoj dhe atë me mbështetjen e kryesisë qëndrore. Unë jam shumë i lumtur dhe krenar me ata që kam arritë me dalë fitues.

**Fidan Ahmeti** – Unë vetëm deshta me ditë se në 4 vitet e kaluara kemi qenë bashkë dhe Kuvendi i ka disa rregulla, e ka shefin që propozon dhe asnjëherë kryesuesi paraprak nuk ka pyet a ka dikush tjetër, apo diçka tjetër. Do të thotë shefat e partive kanë propozue dhe në këtë pjesë ka kalue në vota. Unë nuk jam kundër në personale, por mbetet në ndërgjegjen e secilit.

**Kryesuesi** – Përveç Rregulloreve tjera, që i kemi ne e kemi edhe Rregulloren e punës së Kuvendit Komunal, e cila për secilën pikë të rendit të ditës përveç shefave i'u jepë mundësi secilit anëtar të Kuvendit me marrë fjalën, edhe me propozue dhe çdo gjë tjetër.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së z.Mirena për orarin e kujdestarisë të barnatoreve në Obiliq. Sipas kërkesës kërkohet që mungesa e barnatoreve kujdestare në Komunë të përfshihet në rend dite pasi që po iu shkakton vështirësi qytetarëve, të cilët detyrohen të udhëtojnë jashtë për barna urgjente. Ne që kemi qenë edhe në mandatin e kaluar në Kuvend e dijmë dhe këtë shqetësim e kemi përmendë disa herë por ka pasur hezitim për të ndërmarrë hapa konkret. Madje në Rregulloren nr.01/2022 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve të Komunës së Obiliqit, ia kemi kushtuar nenin 16, gjithsejt 6 pika vetëm për barnatoret. Pika 3,4,5 dhe 6 e këtij neni obligon kujdestarinë e barnatoreve në koordinim me organet komunale, por që deri më tani nuk po funksionon. Pasi që edhe në mbledhjen e KPF-së e shtjelluam këtë pikë kërkoi nga drejtoresha e shëndetësisë, e cila ka pasë takim me përfaqësuesit e barnatoreve të na njoftoj për rrjedhën e këtij takimi dhe hapave që do të ndërmerren në këtë çështje.

**Albertina Dedinca** – Ju njoftoj se dje kemi pasë një takim me përfaqësuesit e barnatoreve dhe një ndër ata ishte edhe z.Fidan Ahmeti, i cili i përfaqësonte ata. Ne kemi diskutuar dhe jemi duke e parë mundësinë e gjetjes së një modaliteti të përshtatshëm edhe për barnatoret, edhe për qytetarët. Interesi ynë i përbashkët si i yni si i barnatoreve është të bëjmë një zgjidhje për qytetarët. Prandaj, propozimin që do e marrim bashkarisht me ata do t'ju njoftojmë në ditët në vijim.

**Fjolla Nasufi** – Për derisa drejtoresha na njoftoi se është në shqyrtim të kërkesës atëherë, po i presim rekomandimet që na vijnë.

**Fidan Ahmeti** – Pas takimit që kemi pasë me drejtoreshën e shëndetësisë në këtë rast, po flas në cilësinë e përfaqësuesit të barnatoreve jemi duke kërkuar qysh e ceku drejtoresha një modul më të mirin për zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve të Komunës së Obiliqit.

**Kryesuesi** – Është shumë e rëndësishme që qytetarët të marrin shërbimet e duhura dhe sido që të merreni vesh është edhe një Rregullore që i specifikon qështjet që është mirë të respektohet.

**Abdyrrahman Krasniqi** – Unë e falenderoj drejtoreshën deputetin por edhe përfaqësuesit e barnatoreve. Mendoj se ndoshta drejtoreshë kishte me qenë mirë me dhënë një afat 2 - 3 javësh, sa don kohë kjo punë për sa ne mund të dalim me një orar duke pasë parasysh ankesat e qytetarëve.

**Albertina Dedinca** – I nderuar z.Abdyrrahman, qysh e përmenda edhe më herët, e kemi mbajtur një takim njoftues më shumë konsultativ dhe posa ta gjejmë këtë modul të përbashkët që besoj se brenda këtij muaji vijmë me një vendim. Padyshim se do të njoftoheni edhe ju edhe qytetarët përmes rrjeteve sociale dhe ju këtu në Kuvend.

#### **Pika 9 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e rekomandimit të KPF-së, për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit. Duke pasë parasysh gjendjen aktuale të mbledhjes së mbeturinave në Komunën e Obiliqit, nevojiten ndryshime pozitive për ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarët. Ashtu qysh u dakorduam edhe në mbledhjen e KPF-së, kjo Rregullore duhet të dalë në debat publik dhe ndryshimet që parashihen në këtë Rregullore janë plotësim ndryshim me fokus në fakturim dhe në inkasim ku operatori ekonomik ka përgjegjësi ekskluzive për fakturim dhe mbledhjes së pagesave. Riformulohet kategorizimi i gjeneruesve familje, biznese, institucione, OJQ, vendosen tarifa të qarta sipas kategorive dhe niveleve të shërbimit, synohet rritja e efikasitetit financiar dhe qëndrueshmëria e shërbimit.

**Fjolla Nasufi** – Jemi në rregullë me këtë pikë dhe nuk kemi diçka konkrete.

**Fitore Hashani** – Do të presim ti japim komentet tona dhe sugjerimet gjatë debatit publik.

**Kryesuesi** – Ju lus të gjithëve, secili që ka mundësi të jepni një kontribut në mënyrë që ta bëjmë një Rregullore sa më të mirë sepse problemi i mbeturinave tashmë është problem shumë i madh për qytetarët tonë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për morën Vendim për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

#### **Pika 10 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Unë kisha me kërkun prej Kryetarit me dhënë një shpjegim lidhur me obligimin ligjor për zgjedhjen e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, të na tregoj a ka ndërmarrë ndonjë hap apo don të bëjë ndonjë propozim para Kuvendit.

**Kryetari** – Unë sot kam për ta propozuar edhe një emër dhe ju lus që ta mbështetni sepse është obligim ligjor dhe Komuna jonë ka nevojë për një Nënkyetar të Komunës për Komunitete. Unë po flas për një figurë që do ta propozoj, i cili është me fakultetin e inxhinierisë industriale dhe gjithashtu e ka tëpërfunduar edhe fakultetin e mbrojtjes në punë. Është i lindur me 3 gusht 1992, jeton në Plemetin, dhe emri i tij është Stevan Radosavljevic.

**Fitore Hashani** – Dua të di arsyen e rivotimit për herën e tretë të personit në fjalë.

**Enver Gashi** – Kryesues, ishte pyetja a është i njejtë që më duket se është reale me na tregue a është apo nuk është.

**Kryesuesi** – Po është i njejtë dhe është kompetencë e Kryetarit të Komunës, i cili ka të drejtë të propozon sa herë don derisa të merret vendim për këtë propozim.

**Goran Dancetovic** – Në periudhën paraprake kam pritur më shumë mirëkuptim për këtë gjë që të mundemi që të mund ta afrojmë këtë institucion me qytetarët e komunitetit serb dhe komuniteteve tjera joshumicë. Por mesa duket dëshira e kryetarit është që me çdo kusht ta propozojë këtu këtë të sigurtin Stevan Radosavljeviq në pafundesi dhe mendoj se në këtë periudhë të tregojmë sinqeritet dhe të gjejmë një zgjidhje kompromisi e cila kishte me qenë e pranueshme për të gjithë.

**Kryesuesi** – Pikërisht këtë e kërkoi edhe Kryetari që të kemi kompromis.

**Kryetari** – Pikërisht për seriozitet po flasim, unë kam kërkue dhe vazhdoj me kërkue, kam pasë ankesa nga anëtarët e Kuvendit këtu pse nuk e kam prezentue CV-në e personit në fjalë. Tash fillova me CV dhe e përfundova me emrin dhe mbiemrin e tij. Unë kërkuj nga ti dhe nga kolegëja jote që ta votoni propozimin tim sepse komuniteti serbë ka nevojë edhe për përfaqësim në qeverisje. Pra, Stevan Radosavljevic, është i propozuari im që unë pres ta votoni edhe ju.

**Goran Dancetovic** – Duke pasur parasysh se ju propozuat kandidat për nënkryetar nga komuniteti ynë,

ne e dimë biografinë e tij më mirë se ajo që keni lexuar. Kështu që nuk do ta mbështesja një njeri me një biografi të tillë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal votuan me 12 vota për dhe 7 vota kundër për zgjedhjen e z.Stevan Radosavljevic, Nënkyetar i Komunës për Komunitete.

**Kryesuesi** – Duke pasë parasysh se ky votim kërkon votimin e dyfishtë, kërkon votimin e të gjithë anëtarëve të Kuvendit si dhe shumicën e anëtarëve të komuniteteve, konsideroj se ky propozim nuk kalon.

**Fidan Ahmeti** – Unë kam kërkesë për zebra në rrugë sidomos nga elektrobartja po mungojnë shumë konkretisht te lagjja e Bërbatovcëve, Nasufëve dhe lagjja Aliu po kalojnë shumë njerëz dhe zebra mungojnë. Prandaj, mundësisht në disa pjesë ku nuk ka zebra me i vendos.

**Dorentina Mustafa** – Duke marrë parasysh rritjen e fundit të çmimit të derivateve, gjë e cila po ndikon drejtpërdrejtë edhe në sektorin e bujqësisë, kërkuj nga Komuna përkatësisht nga Drejtoria përkatëse që të ndërmarrë masa konkrete në mbështetje të bujqëve tonë. Nëqoftëse tashmë ka filluar sezoni i punimit të tokave dhe kostoja e derivateve po vështirëson seriozisht punën e tyre, propozoj që bujqëve të cilët punojnë tokat bujqësore nga 1 hektarë e më shumë të iu ofrohet një subvencion si mbulesë deri në 100 euro për ti mbuluar një pjesë të shpenzimeve për derivate. Kjo do të ishte një ndihmë e drejtpërdrejtë dhe e nevojshme për ta lehtësuar barrën e tyre dhe për të mbështetur prodhimin vendor.

**Fitore Hashani** – Kryesues, kam 2 pyetje dhe njëra lidhet me emisionin në KTV në mes të Kryetarit të Komunës z.Halil Thaqi dhe intervistës time si përfaqësuese e grupit të Lidhjes Demokratike. Aty, Kryetari i ngriti disa çështje, por 2 prej tyre janë me interes për neve. Dua të dimë nëse janë nisë procedurat hetimore sa i përket kontratës së drunjve dhe nëse, është inicue në Prokurori të shtetit, si dhe kontrata tjetër e renovimit të shkollave nëse, është respektue kjo kontratë me kontratën në shtëpi dhe këto shërbime janë krye prej NPL "Kastrioti". Nëse, jo duam të dijmë se kush i ka bërë këto renovime dhe si janë përmbyllur.

**Linda Bekteshi** – Unë i kam 2 kërkesa nga qytetarët; e para është rreth realizimit të mjeteve për transport të nxënësve të rregulltë dhe atyre me nevoja të veçanta, kur do të bëhet ndarja e këtyre subvencioneve sepse qytetarët janë në pritje të këtyre mjeteve. Po ashtu, e kam edhe një kërkesë të përfshirja e fëmijëve në kopësht, ka kërkesa të shumta nëse ka zhvillim të rregulltë të rregullimit të energjisë, apo nëse ka ende vende të lira në kopshtin në Milloshevë për pranim të fëmijëve.

**Muhamet Preniqi** – Deshta një sqarim nga Kryetari lidhur me transportin publik që e kemi potencu edhe në seancat e kaluara të dimë se deri ku kanë shku procedurat. E kam edhe një pyetje për Kryetarin; kam ankesa nga qytetarët dhe nga shërbyesit e NPL-së, deshta një sqarim nga Kryetari me ditë se kush është Egzon Zhegrova, që po i menaxhon NPL-të nëpër Obiliq dhe çerdhet, në cilësinë e çfarë personi është i autorizuar ky nga dikush.

**Kryesuesi** – Ishte kërkesa për zebra dhe kërkesa nga znj.Dorentina, që do të shqyrtohen nga drejtorët përkatës të cilët pastaj do të vijnë në seancën e ardhshme me përgjegje.

**Kryetari** – Ishte pyetja për Prokurorinë, unë nuk jam përfaqësues i Prokurorisë nuk e di, por sigurisht se unë kam bërë thirrje publike me u marrë prokurori me këtë çështje dhe mirë është që prokurori të merret me këtë punë. Te pyetja tjetër besoj se nuk është dashur të paktën ty si ishdrejtoreshë e Arsimit me të pengue investimet nëpër shkolla sepse ti e din në çfarë gjendje e ke lënë shkollën, ti e din a ke lënë lëndë djegëse nëpër shkolla a jo, ti e din.. Sa i përket personit në fjalë që e bëri pyetjen z.Muhamet sigurisht se e ka një kontratë që punon, çdo person është dashtë me pasë kontratë dhe nuk është dashtë me punue mësimdhënës pa kontratë për shembull qysh kemi pasë raste kemi gjetë mësimdhënës që kanë punue pa kontratë. Mirëpo, të gjitha këto janë çështje me të cilat sigurisht se merret Prokuroria.

**Kryesuesi** – Ishte pyetja edhe për mjetet e transportit dhe subvencionet znj.Linda sigurisht se në seancën në vijim do të keni një përgjegje si dhe përfshirja e fëmijve në kopshte gjithashtu.

**Bajram Hashani** – Edhe unë dua të ndërlihem te intervista e Kryetarit me KTV-në, lidhur me shkarkimin e 2 drejtorëve të drejtorit të shkollës së mesme të lartë profesionale Jakup Hashani dhe Bedri Nezirit në shkollën "Pandeli Sotiri". Kryetari i ceku disa arsye për shkarkimin e tyre që mund të jetë suksesi një prej arsyeve, por Kryetari duhet me ditë se këto shkolla me të vërtetë kanë edhe suksese të shumta. Ju lus të dëgjoni 2.3 gjëra, që do të ua përmendi sepse duhet me qenë brenda për me i ditë gjërat se jam edhe pjesë e atij kolektivi. Në vitin 2025 në qershor nxënësi i shkollës tonë Ari Salihi është shpërblye me medalje të bronzit në garat ndërkombëtare të kodimit të mbajtura në Barcelonë. Pra, ky është një sukses dhe ai është nxënës i shkollës tonë. Nxënësit e shkollës tonë për çdo vit punësohen në KEK që e kemi një marrëveshje, ndër ta dalin nxënës shumë mirë. Mirëpo, ne kemi edhe nxënës që na vijnë me dysha e deri në fund të vitit i kanë pasë njësha dhe ne i dijmë këto gjëra. Atë nxënës është vështirë me i kthy dhe me bë të shkëlqyeshëm. Shkolla e mesme profesionale është zanat se duhet me aftësue një punë duhet me ditë me bë, do të thotë se ato nuk janë arsye për me i shkarku drejtorët. E kam edhe një pyetje tjetër që po e citoj te pyetja aty e qytetares kur iu bë që kanë dalë diplomat fals prej asaj shkolle dhe Kryetar tu kisha drejtu nëse, vërtetë ke njohuri që prej shkollës "Ismail Dumoshi" janë dalë ato diploma ngrite procedurën, hap hulumtim le të vijnë te kontrollojnë. Unë dëshmoj këtu, se ato diploma të gjitha janë verifikuar dhe asnjë prej tyre nuk janë dalë prej shkollës "Ismail Dumoshi".

**Kryetari** – Nuk është punë e imja as e jotja me i verifikue

**Bajram Hashani** – Mirëpo, edhe me akuzue pa nevojë, është shkarku drejtori për shkak të diplomave që decedivisht kështu, i ra ajo ishte pyetja jote, do të thotë është akuzë e rëndë Kryetar, seriozisht duhet me i matë fjalët pak kur të thuash një diçka sepse përgjegjësinë për fjalën publike e japim të gjithë.

**Kryetari** – Ti për fjalën time ndërsa, unë për tënden.

**Bajram Hashani** – Jo, unë për fjalën time ndërsa ti për fjalën tënde.

**Kryetari** – Nuk ka dhe nuk bën me pasë më drejtorë 12 vjet drejtor me atë nivel të pastërtisë, me atë nivel të rregullit dhe nuk po merrem unë me emra, por i'u kam tregu, i'u kam dhënë hapësirë drejtorëve në mbledhjen e parë që e kam mbajtur. Unë ju kam thënë drejtorëve se dua me ju pasë juve drejtorë, e jo më drejtor me qenë punëtori teknik se drejtori. E dini gjendjen qysh është nëpër shkollë dhe unë nuk kam çka me folë hiç për atë punë, e dijmë nivelin sepse 55 % të nxënësve të klasëve të 10-ta dhe 11-ta janë me nota të dobëta, 47 % të klasëve të 7-ta dhe 8-ta janë me nota të dobëta. Edhe ka drejtorë ka njerëz që merren me politikë që kërkojnë një drejtor të tillë me ia vazhdu mandatin, e nuk ka me i'u vazhdu mandati.

**Bajram Hashani** – Ai drejtori yt a është politik që e ke emëru, me çfarë performance është, e jo veç ad hoc hajt bënë atje drejtor.

**Muhamet Preniqi** – Sa i përket drejtorëve, kemi kohë me ua shikue marifetin, por sa i përket pyetjes që e bëra për transportin publik nuk më dhe asnjë përgjigje që 3 seanca jemi duke e bërë kërkesën.

**Enver Gashi** – Kryetar pak më qetë, në poste menaxhuese jam 40 vjet, vetëm një po të tregoj dhe duhet me na u përgjigjë këtu se këta njerëz që janë largue sigurisht se e bëjnë nga një ankesë të vogël edhe nëse, nesër kthehen dhe kompensohen ato mjete kush i paguan dhe kush është përgjegjës. Nuk është mirë me lue me taksat e qytetarëve, e ke postin e Kryetarit mbaje qysh duhet, mbaje me nder me respekt e jo me lue me buxhet, jo me lue me mjetet e taksave të qytetarëve sepse ata i marrin mjetet.

**Kryetari** – Z.Gashi a bën një pyetje me ta bë, a ke qenë ti në shkollën teknike e para, a e din nivelin e mësimdhënies, a e din rregullën brenda shkollës a jo. Është e natyrshme normal që ne mos me u pajtue në shumë çështje, kjo është vizioni dhe politika jonë. Ne kemi me i ndërru ata drejtorë që nuk dojnë me punu, ata drejtorë që pijnë raki në orar të punës nuk kanë me qenë drejtorë. Ky është vizioni dhe politika ime. Ai drejtor që nuk ka sukses nuk ka me qenë drejtor.

**Enver Gashi** – Krejtë në rregullë por qka nëse nesër e kthen gjygi, ato mjete kush i jepë. Supozojmë e kthen gjygi x drejtorin, x punëtorin administrativ kush i paguan ato mjete.

**Kryetari** – Kurrë nuk ka me u kthye ai hiç.

**Labinot Mirena** – Çështja e transportit, çështja e barnatoreve, çështja e çerdheve, çështja e mbeturinave krejtë këto janë që i keni trashëgue prej neve dhe ju për 2 muaj nuk mundeni me rregullue as transportin, as çerdhen, që janë shkue nxënësit e është dashtë me i heqë nxënësit që nuk ka pasë as trafo, e as krejtë këto problematika. Mua, më vjen mirë që po flasim këta kolegë sepse po kanë mundësi me folë tash se këta është dashtë me i krye punët, kanë qenë nëpër pozita.

**Muhamet Preniqi** – Tepër 12 vjet, drejtor me atë kolegun tënd aty është dashtë me i krye këto muhabete shumë më herët, e mos me u marrë këta me këtë punë.

**Labinot Mirena** – Unë z.Muhamet e përshëndes dhe i uroj suksese.

**Muhamet Preniqi** – Edhe unë të përshëndes ty shumë faleminderit.

**Abdyrrahman Krasniqi** – Unë po çuditem me kolegët e Lidhjes Demokratike.

**Bajram Hashani** – Po e dëshmon që nuk është më në Lidhjen Demokratike.

**Abdyrrahman Krasniqi** |– Kush është ky që po i kryen punët me përmendë emra është absurditeti më i madh me thënë se kush është ky person që po i kryen punët dhe unë kësi lloj debati nuk kam parë as nuk kam dëshirë me pa. Mendoj se qeverisja është ndërrue dhe kisha me qenë kritik dhe jam kritik nëse, një njeriut meritohet ose një njeriut me performancë i ndryshohet pozicioni duke pasë parasysh se qytetarët po na votojnë të gjithëve me punue në interes të qytetarëve, të vendit dhe të Komunës. Unë për vete nuk kam njohuri pse janë shkarku ata drejtorë, por nëse kanë pasë performancë të keqe atëherë, është Kryetari që vendos sepse qytetari ia ka dhënë të drejtën me menaxhue këtë Komunë. Nëse, nuk ka performancë në Arsim, qytetarët prapë kanë me kërkue llogari prej Kryetarit, por unë mendoj se ndoshta kishte me qenë mirë që ne me ndihmu procesin me thënë se çka mund të bëjmë ne që të përmirësohemi. Në këtë kontekst bëhet politika, e jo me përmendë emra; e shkarkove këtë sepse e kam pasë shok, kjo nuk është politikë as nuk ka të bëjë me politikë.

**Bajram Hashani** – Me të vërtetë, nëse punoni për Arsimin dhe shkollën prej shtatorit në shkollën “Ismail Dumoshi” janë 2 norma në arkivin elektroteknik pa mësimdhënës që edhe ne kemi përgjegjësi që kemi qenë, por ju jeni që 4 muaj në pushtet dhe ata nxënësja janë pa mbajtur orë, shumë keq. Këtu, ju duhet me punue me plotësu kuadrin që nxënësit me i mbajte orët.

**Kryesuesi** – Faleminderit z.Hashani për përkushtimin.

Mbledhja përfundoi në ora 12:12’


Zyrtare e lartë për punë të KK



Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Sami Ahmet



REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić – Municipality Assembly Obilić

### IZVOD IZ ZAPISNIKA

